



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1148/1.Prot

Gramsh më, 12.04.2021

**VENDIM**

Tr. 44 dt. 22.04.2021,  
**PËR**

**“ Miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti në banesën e z. Qazim Feimi, banor në fshatin Paktos, Njësia Administrative Kushovë, si dhe dëmshpërblimin financiar”.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “Për miratimin e vlerës financiare, të dëmeve shkaktuar nga tërmeti në banesën e shtetasit **Z. Qazim Feimi**, banor në fshatin Paktos, Njësia Administrative Kushovë, si dhe dëmshpërblimin financiar”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh.
2. Të miratohet vlerën e dëmshpërblimit financiar bazuar në V.K.M. Nr. 329 datë 16.5.2012 e cila është **50%** të vlerës së preventivit të përlllogaritur bazuar në dëmet e shkaktuara nga tërmeti në banesë, d.m.th. **675 706 x 50% = 337 853** lekë, pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z. Qazim Feimi** është në **337 853** (treqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.
3. Ti paraqesë dokumentacionin përkatës dhe ti kërkojë mbështetje financiare Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministrisë së Mbrojtjes, për akordimin e dëmshpërblimit prej **337 853** (treqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, për shtetasin **Z. Qazim Feimi**.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektori I Emergjencave Civile ).

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

**XHULIA GJINI**

Konceptoi: Xh. Gjini  
Pranoi: G. Lena  
Miratoi: G. Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_



KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

**GRETA LENA**